




Funded by
the European Union

Pagesat për konsumin e energjisë elektrike në komunat veriore në Kosovë



Deklaratë mohimi:

Ky publikim është botuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi e vetme e Institutit GAP dhe Kosovo 2.0 dhe në asnjë mënyrë nuk mund të paraqes pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

— Përmbajtja

Hyrje	3
Konsumi i energjisë dhe vlera e paguar për komunat veriore ndër vite	4
Përfundim	8



Hyrje

Që nga pas lufta, çështja e pagesës për konsumin e energjisë elektrike në komunat veriore të Kosovës ka mbetur e pazgjidhur. Si e tillë, nga viti 1999 deri në 2017, shpenzimet për energjinë elektrike të shpenzuar në katër komunat veriore të Kosovës (Mitrovicë e Veriut, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan) janë trajtuar si "humbje të energjisë" nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), dhe ngjashëm me humbjet e tjera të rrjetit, janë përfshirë në tarifat e konsumatorëve të pjesës tjetër të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, shpërndarja e energjisë elektrike në këto komuna është bërë jashtëligjshëm nga ndërmarrja elektrike serbe (Elektroprivreda Srbije (EPS)), përmes filiales, Elektrokosmet. Kjo ndërmarrje nuk ka poseduar licencë për të kryer këto aktivitete, meqenëse sipas Rregullatorit të Energjisë në Kosovë, ndërmarrja e vetme e licencuar për shpërndarje të energjisë ishte Kompania Kosovare për Shërbimet e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (KEDS).¹

Në mënyrë që të ofrohet një zgjidhje për këtë situatë, në vitin 2013 u nënshkrua Marrëveshja për Energjinë në mes të Kosovës dhe Serbisë, përcjellur nga një marrëveshje për implementimin e marrëveshjes së parë në vitin 2015, e cila parashihte themelimin dhe operacionalizimin e një ndërmarrjeje të re të furnizimit me energji elektrike për katër komunat veriore. Kjo ndërmarrje duhet të ishte e regjistruar në Kosovë dhe do të blente dhe shiste energji elektrike për të shërbyer konsumatorët e komunave veriore. Në vitin 2019, ndërmarrja "ElektroSever" (në pronësi të EPS) u regjistrua në Kosovë, dhe më pas në vitin 2020, aplikoi për licencë të furnizimit me energji elektrike në ZRRE. Procesi i shqyrtimit të licencës dhe dhënia e licencës nga ZRRE ka përfunduar më 24 qershor 2022, sipas marrëveshjes së re të arritur në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë.²

Deri më tani, shpenzimet e energjisë elektrike në këto komuna janë paguar nga qytetarët e pjesës tjetër të Kosovës, e më pas nga Operatori i Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT) dhe subvencioneve qeveritare. Siç u përmend më lart, deri në dhjetor të vitit 2017, energjia e furnizuar në këto komuna u trajtua si "humbje e energjisë"; mirëpo, në fund të vitit 2017, bazuar në çështjen e ngritur nga Avokati i Popullit dhe vendimit të organeve gjyqësore, u vendos që kjo "humbje" të mos mbulohet përmes tarifave të qytetarëve, por nga KOSTT. Deri më tani, KOSTT vazhdon të mbulojë me të hyrat e saj energjinë e konsumuar në katër komunat veriore. Për më shumë, në vitin 2020 dhe 2021 është kërkuar ndihmë financiare nga Kuvendi³ dhe janë ndarë mjete nga buxheti i Kosovës, në mënyrë që të mbulohet një pjesë e këtyre shpenzimeve.⁴ Megjithatë, në takimin e datës 21 qershor 2022 në mes të Kosovës dhe Serbisë në Bruksel, u arrit marrëveshje për këtë çështje. Më konkretisht, të dy palët u dakorduan për aprovimin e një udhërrëfyesi për zbatimin e marrëveshjeve të energjisë të viteve 2013 dhe 2015.⁵ Përmes kësaj marrëveshje të re, qytetarët në komunat veriore do të faturohen dhe do të paguajnë për konsumin e energjisë elektrike.

1 Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti vjetor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3xVD10d>

2 Koha.net, 2022. "Elektroseverit" i jepet licenca për furnizim të veriut me energji elektrike. Burimi: <https://bit.ly/39SOA7t>

3 Kjo kërkesë është bërë tek Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti dhe pas aprovimit nga Komisioni, u votua nga Kuvendi.

4 Evropa e Lirë, 2021. KOSTT: Kosova vazhdon ta furnizojë veriun me rrymë. Burimi: <https://bit.ly/3xZChar>


5 Koha.net, 2022. Udhërrëfyesi i plotë për Marrëveshjen e energjisë në veri [DOKUMENT]. Burimi: <https://bit.ly/3xGYZD0>

Konsumi i energjisë dhe vlera e paguar për komunat veriore ndër vite

Në Kosovë, prodhimi i energjisë elektrike bëhet kryesisht nga termocentralet dhe një pjesë më e vogël nga hidrocentralet, turbinat me erë, centralet solare dhe nga importi. Meqenëse, energjia e prodhuar në vend nuk e mbulon kërkesën për energji në kohën e kërkesës maksimale, atëherë paraqitet nevoja për import. Gjatë vitit 2021, kishte një krizë energjetike ndërkombëtare, e ndikuar nga rezervat e ulëta të gazit në stoqet evropiane si pasojë e kufizimeve në furnizimin me gaz nga ana e Ruisë, kërkesa për gaz në Azi, dhe rritja e kërkesës për energji elektrike si rrjedhojë e rimëkëmbjes ekonomike pas pandemisë.⁶ Kjo krizë u shfaq me një rritje të madhe të çmimeve të energjisë elektrike në gjysmën e dytë të vitit 2021, ku çmimet në bursën hungareze të energjisë elektrike arritën vlerën prej 376 euro/MWh. Kjo rritje e çmimeve u reflektua edhe në Kosovë, marrë parasysh që pati rritje të konsumit të energjisë elektrike në dhjetor 2021 prej 10.8% krahasuar me vitin e kaluar, dhe rrjedhimisht nevoja për import ishte edhe më e madhe. Sipas të dhënave nga ZRRE, vetëm gjatë dhjetorit 2021 u importua energji elektrike në vlerë prej 32.3 milionë euro.⁷

Ndër vite, kërkesa për energji elektrike në Kosovë ka qenë stabile, me një rritje pak më të theksuar në tri vitet e fundit.

Figura 1. Kërkesa për energji elektrike në Kosovë ndër vite (në GWh)




Burimi: Zyra e Rregullatorit të Energjisë, 2022

Një sfidë që ende vazhdon të mbetet në tregun e energjisë, përkundër investimeve që janë realizuar ndër vite në rrjetin e shpërndarjes, është niveli i lartë i humbjeve. Kjo ndodhë si pasojë e vjetërsisë së rrjetit, gjatësisë së linjave, kualitetit dhe llojit të përcuesve dhe transformatorëve, ngarkimit të pajisjeve dhe mirëmbajtjes së tyre. Gjatë vitit 2021, humbjet teknike arritën vlerën prej 12.46% të gjithsej kërkesës në shpërndarje, ndërsa ato jo-teknike (komerciale), ishin 6.16% të gjithsej kërkesës në shpërndarje. Deri në vitin 2017, konsumi i energjisë në komunat veriore u trajtua si humbje komerciale e energjisë; ndërsa nga dhjetori i atij viti, u listua si 'energji e pafaturuar'.⁸

⁶ Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti vjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3xyDWT4>

⁷ Ibid.

⁸ Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Raporti vjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3xyDWT4>

Figura 2. Humbjet e energjisë elektrike dhe kërkesa për energji elektrike (në GWh)

Burimi: Zyra e Rregullatorit të Energjisë, 2022

Sipas të dhënave nga ZRRE, mesatarja e humbjeve të energjisë në komunat veriore ishte rreth 260 GWh (1,700 GWh mesatarja e gjithsej humbjeve) në vit. Nga viti 1999 e deri në vitin 2017, këto shpenzime janë përfshirë në faturat e konsumatorëve të qyteteve tjera të Kosovës. Është llogaritur që përafërsisht faturat e qytetarëve në këtë periudhë ishin për rreth 3.5% më të shtrenjta.⁹ Sipas të dhënave të shfaqura në tabelën më poshtë, nga viti 2011, konsumi i energjisë në këto komuna ishte në rritje, mesatarisht rreth 5% në vit. Megjithatë, në dy vitet e fundit vërehet një rritje më e lartë, prej rreth 14% dhe 11%, përkatësisht. Nëse krahasohet me ndryshimin vjetor të kërkesës totale për energji elektrike në Kosovë, vërehet se në vitin 2020 kishte një rritje relativisht të ulët të kërkesës prej 2.8%, e që mund të jetë si pasojë e mbylljes së ekonomisë për periudha të caktuara gjatë pandemisë. Kjo rritje në konsum të energjisë në këto komuna u arsyetua se po ndodhë për shkak të koncentrimit të prodhimit të kriptovalutave aty, meqenëse pajisjet për prodhimin e kriptovalutave kanë shpenzime të mëdha të energjisë (një pajisje mund të shpenzojë deri në 150 euro energji elektrike për një muaj). Sipas të dhënave të importeve për periudhën 2017–2018, u raportua që janë importuar pajisje për prodhim të kriptovalutave në vlerë rreth 3 milionë euro.¹⁰

Tabela 1. Energjia e konsumuar në komunat veriore në GWh dhe ndryshimi vjetor (%)

2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021
185.33	213.71	210.84	218.15	229.67	246.55	251.94	265.29	271.92	294.29	334.74	371.69
-20.4%	15.3%	-1.3%	3.5%	5.3%	7.3%	2.2%	5.3%	2.5%	8.2%	13.7%	11.0%

Burimi: Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Duke marrë parasysh mungesën e furnizimit me energji elektrike në fund të vitit 2021, Qeveria në kuadër të "Masave të emergjencës për furnizim të energjisë", ndaloi prodhimin e kriptovalutave në gjithë territorin e Kosovës.¹¹ Në këtë periudhë, shumë pajisje janë sekuestruar përkohësisht nga Dogana e Kosovës, ku një numër prej tyre nuk ishin të zhdoganuara.


⁹ Evropa e Lirë, 2021. KOSTT: Kosova vazhdon ta furnizojë veriun me rrymë. Burimi: <https://bit.ly/3N0m356>

¹⁰ Kallxo, 2021. Fakte se si ndikoi biznesi i kriptovalutave në rritjen e kërkesës për rrymë në katër komunat veriore. Burimi: <https://bit.ly/3xAeY5B>

¹¹ Zyra e Kryeministrit, 2021. Mbledhja e 51-të e Qeverisë. Burimi: <https://bit.ly/3N0m9cY>

Nëse e analizojmë si vlerë koston e energjisë së konsumuar në veri ndër vite, shohim që për një periudhë dhjetë vjeçare, janë shpenzuar mesatarisht 11 milionë euro në vit për mbulimin e kësaj kostoje, ndërsa si total, janë shpenzuar 132.5 milionë euro. Deri në vitin 2018, kjo kosto ishte më e ulët se 10 milionë euro; ndërsa nga viti 2018, ka filluar të rritet, duke arritur kështu vlerën më të lartë në vitin 2021, në vlerë prej rreth 38 milionë euro.

Figura 3. Vlera e konsumit të energjisë në komunat veriore (në mil. Euro)



Burimi: Zyra e Rregullatorit të Energjisë, 2022

Nga fundi i vitit 2017, pagesa për energjinë e konsumuar në komunat veriore u realizua nga ndërmarrja publike Operatori i Sistemit të Transmisionit të Kosovës (KOSTT), nga të hyrat vetanake të saj, si dhe me asistencë nga subvencioni qeveritar, aprovuar nga Kuvendi i Kosovës. Në vitin 2020, KOSTT ka kërkuar ndihmë financiare nga qeveria e cila u aprovua përmes Ligjit për buxhet ku u ndanë 10 milionë euro. Ministria e Ekonomisë gjatë 2020, dorëzoi një plan të veprimit për normalizimin e shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike në veri të Kosovës.¹² Lidhur me këtë, përfaqësuesit e ZRRE dhe KOSTT në maj të vitit 2020 diskutuan me Komisionin parlamentar për të drejtat e njeriut, barazi gjinore, për persona të pagjetur dhe peticione. Në këtë takim u diskutua që duke mos pasur mundësi të shtrihet operimi në këtë pjesë, është tërhequr energji nga rrjeti i interkoneksionit të rrjetit evropian, dhe në këtë mënyrë Kosova ka hyrë në obligime ndaj Rrjetit Evropian të Operatorëve të Sistemit të Transmisionit (ENTSO). Lidhur me këtë, meqenëse KOSTT tanimë është pavarësuar nga blloku rregullues me Serbinë, Maqedoninë e Veriut dhe Malin e Zi, dhe është futur në bllok rregullues me Shqipërinë, është kërkuar nga ENTSO që Kosova të garantojë që nuk do të ketë më devijime në sistem. Për këtë arsye, KOSTT ka kërkuar asistencë financiare nga Kuvendi, në mënyrë që të ndërpriten dënimet nga rrjeti ndërkombëtar.¹³ Ngjashëm me vitin 2020, edhe në vitin 2021, KOSTT mbuloi shpenzimet e energjisë në komunat veriore nga buxheti vetanak në vlerë prej 34 milionë euro, dhe pjesa tjetër u mbulua nga subvencioni i qeverisë në vlerë prej 7.6 milionë euro. Sipas raportit të ZRRE-së, në vitin 2021 u shpenzuan gjithsej 41.8 milionë euro për këtë arsye.¹⁴

¹² Zyra e Rregullatorit të Energjisë, 2020. Raporti vjetor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3xCTDbG>

¹³ Kuvendi i Kosovës, 2020. Procesverbal i mbledhjes së Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për persona të pagjetur dhe peticione. Burimi: <https://bit.ly/3O5LovS>

¹⁴ Zyra e Rregullatorit të Energjisë, 2021. Raporti vjetor 2021. Burimi: <https://bit.ly/3Oj2Ogn>

Këto pagesa milionëshe që janë bërë ndër vite kanë pasur ndikim mjaft të madh në tregun e energjisë në Kosovë. Fillimisht, duke faturuar drejtëpërdrejtë qytetarët në shumë më të madhe se sa që kanë shpenzuar, e më pas duke u bërë barrë financiare për KOSTT dhe buxhetin publik. Për më shumë, siç u përmend më lartë, devijimet e bëra nga KOSTT për të mbuluar konsumin e energjisë në komunat veriore nga rrjeti i interkoneksionit evropian, shkaktuan obligime ndaj ENTSO. Duke operuar si zonë rregulluese nga viti 2020, KOSTT ka përgjegjësi të bëjë balancimin e sistemit dhe mbulimin e të gjitha devijimeve. Gjithashtu, në raportim ndaj ZRRE, KOSTT ka deklaruar se në vitin 2020, realizimi i investimeve kapitale ishte 36%. Ndër arsye tjera, ata raportuan që shtyrja e projekteve kapitale është bërë edhe si pasojë e problemeve financiare për furnizimin e pjesës veriore.¹⁵

Përveç çështjes së mos-pagesës së energjisë elektrike, është raportuar që në komunat veriore nuk paguhet as për ujin e shpenzuar dhe obligimet tatimore. Konsumatorët e këtyre komunave furnizohen me ujë të pijshëm nga Kompania Rajonale Ujësjiellësi "Mitrovica", mirëpo nuk i paguajnë shpenzimet e tyre tek kjo kompani. Nga viti 1999, është llogaritur që borxhi i mbledhur për këto fatura është 15 milionë euro. Tutje, një numër i madh i bizneseve që operojnë nuk janë të regjistruara në Agjencinë e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës, dhe rrjedhimisht nuk paguajnë obligimet tatimore. Sipas të dhënave të raportuara, prej 981 bizneseve të regjistruara në këto komuna, vetëm 255 prej tyre paguajnë tatim në Administratën Tatimore të Kosovës.¹⁶

15 Zyra e Rregullatorit të Energjisë, 2020. Raporti vjetor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3zFszLH>

16 Gazeta Ekonomia. Qytetarët dhe bizneset në vry të Kosovës vazhdojnë të mos i paguajnë faturat e rrymës, ujit dhe tatimet. Burimi: <https://bit.ly/3MYU6KT>

Përfundim


Çështja e energjisë elektrike të konsumuar në komunat veriore të Kosovës ka mbetur e pazgjidhur nga viti 1999 në qershor të vitit 2022. Kjo ka ndodhur meqë Komania Kosovare për Distribuim me Energji Elektrike në Kosovë (KEDS) nuk ka operuar në këtë pjesë, dhe rrjedhimisht nuk ka mundur të mbledhë mjetet financiare përmes faturimit të konsumatorëve. Për këtë arsye, nga viti 1999 e deri në 2017, kostot e këtyre shpenzimeve janë konsideruar si "humbje të energjisë" dhe rrjedhimisht janë përfshirë në faturat e konsumatorëve të qyteteve tjera të Kosovës. Pas kësaj periudhe, kur u vendos nga Gjykata e Apelit që të mos vazhdohet kjo praktikë, këto kosto u mbuluan nga KOSTT dhe me asistencë financiare nga subvencioni qeveritar. Mesatarisht, kosto e shpenzuar për mbulimin e këtyre shpenzimeve është 11 milionë euro në vit.

Në përpjekje për zgjidhjen e kësaj situatë politike, në vitin 2013 u nënshkrua Marrëveshja për Energjinë në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë ku parashihej themelimi i një ndërmarrjeje të re të regjistruar në Kosovë, për furnizim me energji elektrike për komunat veriore. Rrjedhimisht, në vitin 2019, ndërmarrja "Elektrosever" u regjistrua në Kosovë, dhe në vitin 2020 dorëzoi dokumentet e aplikimit për licencë në ZRRE. Megjithatë, licenca nga ZRRE u lëshua më 24 qershor 2022, bazuar në marrëveshjen e re të arritur në Bruksel në mes të Kosovës dhe Serbisë. Kjo marrëveshje u arrit më 21 qershor të këtij viti, ku të dy palët u dakorduan për aprovimin e një udhërrëfyesi¹⁷ për zbatimin e marrëveshjeve për energjinë të arritur në vitin 2013 dhe 2015. Në bazë të këtij udhërrëfyesi, ZRRE obligohet të lëshojë licencën për furnizim në komunat veriore për operatorin "Elektrosever", dhe pas kësaj, "Elektrosever" do të sigurojë të dhënat e fundit të disponueshme për konsumatorët për KEDS dhe KOSTT. Për më shumë, në një afat të caktuar kohor, do të bëhet nënshkrimi i marrëveshjeve teknike në mes të "Elektrosever" me KEDS dhe KOSTT lidhur me ofrimin e shërbimeve. Detajet tjera të afateve dhe obligimeve janë të specifikuar në Marrëveshjen për Energjinë¹⁸ të vitit 2013. Me zbatimin e kësaj marrëveshjeje, qytetarët në komunat veriore do të faturohen dhe do të paguajnë për energjinë elektrike të konsumuar.

Një rekomandim nga Instituti GAP, meqenëse tanimë është arritur marrëveshja për çështjen e energjisë me Serbinë, është që të sigurohet një zbatim adekuat dhe sipas afateve të kësaj marrëveshjeje nga të gjitha palët e përfshira. Për më shumë, marrë parasysh rritjen e shpenzimeve në këto komuna vitet e fundit, një rekomandim do të ishte të rritet numri i kontrollave nga autoritetet përkatëse lidhur me prodhimin e kriptovalutave. Më konkretisht, meqë prodhimi i kriptovalutave nuk është i ndaluar ligjërisht, të kontrollohet procesi i zhdoganimit për pajisjet që bëjnë prodhimin e tyre.

17 Koha.net, 2022. Udhërrëfyesi i plotë për Marrëveshjen e energjisë në veri [DOKUMENT].
Burimi: <https://bit.ly/3xGYZD0>

18 Evropa e Lirë, 2013. Marrëveshja për Energjinë. Burimi: <https://bit.ly/39HPU4S>





Funded by
the European Union

Projekti "Inovacioni për mediat e
qëndrueshme dhe angazhimin qytetar"
i financuar nga BE, implementohet nga:

INSTITUTI GAP
GAP INSTITUTE 

KOSOVO 2.0

